



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 68

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 22 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrativ me:

SUBJEKT: Zj. Joana Duro, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 23.1.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin 2 (dy) veprimtarive publike të kryera nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilat rezultojnë të paraportuara në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

1. “Standarde Evropiane në Laboratorin e ri të Anatomisë Patologjike, duke garantuar jo vetëm shpejtësi për kryerjen e analizave që përcaktojnë diagnozën e sëmundjeve tumorale, por edhe cilësi maksimale të këtij shërbimi, kaq shumë të rëndësishëm për vetë trajtimin e pacientëve”.

Link: <https://www.facebook.com/OgertaManastirliu/videos/919011022431814/>

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 2 (dy) media publike.

2. “Mjekë për Shqipërinë. Me mjekët që përfundojnë së shpejti specializimin afatgjatë në Mjekësi bashkëbiseduam për punësim e tyre në zonat ku ka më shumë nevojë për mjekë specialistë, sipas kontratave që ata kanë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.”

Link: <https://www.facebook.com/OgertaManastirliu/videos/545406207553151/>

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 1 (një) media publike.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 16.2.2023, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 17.2.2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bën me dije se:

1. “...Theksohet së në javën e parë të raportimit kemi qenë në komunikime të vazhdueshme për pajisjen me kredenciale për të vijuar me raportimet.

Sa i përket detajeve të Aktivitetit ju bëjmë me dije se:

Tema e Aktivitetit: Inspektim në Laboratorin e Anatomisë Patologjike në Spitalin Onkologjik pranë ambienteve të QSUT

Ora e Zhvillimit të Aktivitetit: 11.00

Data e Zhvillimit të Aktivitetit: 18 Janar 2023

Folësit Kryesorë: Znj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë

Pjesëmarrësit: Znj. Albana Fico, Drejtor i QSUT, dhe stafi mjekësor i Spitalit Onkologjik.

Gjithashtu sqarojmë se ky aktivitet nuk ka qenë i hapur për publikun dhe nuk ka qenë me pjesëmarrje Medias, por pasqyrohet në rrjetet sociale të Ministres, dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga Mediat kushdo tjetër...”

2. *“...Theksohet së në javën e parë të raportimit kemi qenë në komunikime të vazhdueshme për pajisjen me kredenciale për të vijuar me raportimet dhe në pamundësi për të raportuar në ndërfaqe, MSHMS në kuadër të përmbushjes së detyrimit për të raportuar cdo aktivitet me karakter publik, ka dërguar raportimin për periudhën 19.1.2023-27.1.2023 nëpërmjet postës elektronike në adresat raportime.institucione@kqz.gov.al dhe institucione@kqz.gov.al më datë 19 Janar 2023. Në këtë raportim përfshihet dhe Aktiviteti i sjellë në vëmendje.*

Sa i përket detajeve të Aktivitetit gjeni dhe njëherë si më poshtë:

Tema e Aktivitetit: Takim me Mjekët e Rinj Specializantë të cilët përfundojnë specializimin afatgjatë në Mjekësi

Adresa: Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

Ora e Zhvillimit të Aktivitetit: 10.00

Data e Zhvillimit të Aktivitetit: 23 Janar 2023

Folësit Kryesorë: Znj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë Pjesëmarrësit; Rektori i UMT, Dekani i UMT, Studentë.

Gjithashtu sqarojmë se ky aktivitet nuk ka qenë i hapur për publikun dhe nuk ka qenë me pjesëmarrje Medias, por pasqyrohet në rrjetet sociale të Ministres, dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga Mediat dhe kushdo tjetër...”

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, dhe vendimit nr. 09, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S :

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Joana Duro, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI